

VENDIM
Nr. 39, datë 10.2.2025

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SHPK PËR
SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT NR. 263, DATË 2.12.2024**

Në mbështetje të, nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 65/1 prot., datë 5.2.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të Bordit nr. 263, datë 2.12.2024”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 6.6.2023, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 6.6.2023.

- Me shkresën protokolluar në ERE nr. 2317 prot., datë 30.10.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e saj, si dhe në vijim me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2317/2 prot., datë 8.11.2024, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e munguar për këtë aplikim.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 2.12.2024, u vendos dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. dhe ortakut i vetëm që kontrollojnë interesat e saj bëhet znj. Freda Doçi.

- Me shkresën nr. 65 prot., datë 10.1.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 2.12.2024, duke sqaruar se kuotat nuk janë transferuar te znj. Freda Doçi, për arsye të prishjes së marrëveshjes së shitblerjes mes palëve.

- Nga sa konstatohet nga ana jonë në ekstraktin historik të shoqërisë nuk është bërë asnjë kalim/ndryshim, si e tillë korrespondon edhe me sa thënë dhe kërkuar nga shoqëria se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263/2024.

- Për sa kërkohej nga subjekti, si dhe në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton ndër të tjera se një akt administrativ mund të anulohet ose shfuqizohet nga organi publik që e ka nxjerrë, nga organi epror i tij, ose nga një organ tjetër kompetent, sipas ligjit, vlerësohet të shfuqizohet vendimi nr. 263, datë 2.12.2024, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k.” Si e tillë, kuotat e shoqërisë do të vijojnë të mbahen nga ortakët e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. sikurse rezultojnë para vendimit të bordit të ERE nr. 263, datë 2.12.2024 mbi kërkesën e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin e ERE-s nr. 263, datë 2.12.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e saj.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Proinfinet Consulting” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti